



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:116202

Datë: 31.01.2022

Numri i dokumentit: 02662890

P.nr.4111/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Eroll Gashi, me bashkëpunëtoren profesionale Dafina Ymeri, në lëndën penale kundër të pandehurve E.R. dhe L.N. nga P., të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë PP.II.nr.2244/2016, dt.21.09.2017, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, jashtë seancës me dt.28 Janar 2022, mori këtë:

AKTVENDIM

HUDHET akuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2244/2016, dt.21.09.2017 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurve:

1. E.R., me vendbanim në P., rr.””, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së,
2. L.N., me vendbanim në P., rr.””, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, -pasi që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Pala e dëmtuar: B.N me vendbanim në B., P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur akuzën PP.II.nr.2244/2016, dt.21.09.2017 kundër të pandehurit E.R, L.N. për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 24.09.2020 e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar , nuk ka prezantuar i pandehuri për të cilin gjykata nuk ka prova se është ftuar në mënyrë të rregullt ku edhe ka lëshuar urdhëresë për verifikim adrese policisë së Kosovës, gjithashtu me datë 27.09.2021 e ka caktuar sërish seancën fillestare mirëpo ka munguar i pandehuri edhe pse gjykata ka prova se janë ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa gjyqtari i çështjes pas pranimit të kësaj lënde me datë 21.08.2020 dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të saj, ndaj të pandehurve , për veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, me datë 17.11.2021, ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar , në këtë seancë ka prezantuar prokurori i shtetit , i pandehuri L.N, ndërsa nuk ka prezantuar i pandehuri E. R., për të cilin gjykata ka pasur prova se është ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo i njëjti mungesën nuk e ka arsyetuar.

Andaj duke vepruar sipas detyrës zyrtare gjykata ka konstatuar se ndaj të pandehurve E.R., L.N. për veprën penale Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, ka arritur afati kohor i ndalesës absolute të ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 106 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, vepra penale e cila është e dënueshme më shumë se një (1) vit burgim parashkruhet kur të kanë kaluar 3 vite nga data e kryerjes së veprës penale, kurse sipas dispozitave të nenit 107 par.8 të KPK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 6 vite nga koha e kryerjes së veprës penale, ngase vepra penale është kryer me datë 11.12.2015, ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur me datë 11.12.2021.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPPK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të lartcekur të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 106 par.1 pika 1.5 dhe nenit 107 par 8 të KPK-së, si dhe nenin 253 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Penal
P.nr.4111/17, të dt.28 Janar 2022

Bashkëpunëtore profesionale
Dafina Ymeri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Eroll Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.